- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisive të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbyshja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 616-23-13568-5-1-1/C1543

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 122,967.80 EUR.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <p>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p> <p>(ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 15 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës..
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 15 dite pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 240 ditë kalendarike.
Dëmet e likuiduara	19.1	<p>Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.</p> <p>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.</p>
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,

Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës
Parimet përgjithshme pagesave	24	Autoriteti Kontraktues do të paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione në vlera minimale nga 30.000,00 € e me tepër për punët e kryera dhe të konstatuara nga menaxheri i kontratës.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar pas përfundimit të punimeve me sigurimin e kualitetit të punimeve në afatin e parapare në deklaratën e garancionit. Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve prej: 5 deri në 10 vite varësisht prej deklaratës së garancionit që jep OE e cila do të bëhet sipas pikës 10.1
Shkaqet kompensim për	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuere e defekteve është 10 vite. Deklarata e Garancionit e bashkëngjitur në Kontratë.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën komerciale -në Prishtinë

AFATI I IMPLEMENTIMIT DHE PERIUDHA GARANTUESE

Për:

(në vazhdim: "KOMUNA E PRISHTINËS")

Në emër të: ["EING COM" SH.P.K., Dumosh, Podujevë]

(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: Renovimi artistik dhe infrastrukturor i tunelit të kurrizit „Dardani”

Numri i Prokurimit: 616-23-13568-5-1-1

Deklaratë e Operatorit Ekonomik për Afatin e Implementimit të projektit dhe Periudhën Garantuese

DERISA ne si tenderues kemi ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një ofertë në të cilën kriteri i dhënies është Tenderit Ekonomikisht Më i Favorshëm (TEMF), bazuar në nën kriteret për PERIUDHËN GARANTUESE dhe AFATIN E IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT, DEKLAROJMË se do të përmbushim kërkesat e Autoritetit Kontraktues për këtë projekt për një periudhat e përcaktuara si më poshtë:

I. AFATI I IMPLEMENTIMIT të këtij projekti është: 240 ditë, nga data e fillimit të punëve e përcaktuar nga Menaxheri i Kontratës.
Shëno numrin e ditëve

II. PERIUDHA GARANTUESE vlen 10 vite vite nga data e pranimit të përkohshëm të projektit nga Autoriteti Kontraktues, për projektin e cekur në këtë deklaratë.
Shëno numrin e viteve

Eljesah PODVORICA

Emri i përfaqësuesit të OE

Nënshkrimi

Vula



dieform

Address
Radovan Zogoviç Nr.97
Bllok C3 | HY A4
Prishtinë | Kosovë

E-mail:
info@dieform.space

PARAMASA DHE PARALLOGARI A					
PROJEKTI		RENOVIM I INFRASTRUKTUROR DHE ARTISTIK I TUNELIT TË KURRIZIT			
LOKACIONI		LAGJA DARDANIA PRISHTINË			
INVESTITORI		KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS			
VËREJTJE:					
Në çmim njësi duhet të parashihet blerja, furnizimi, punimi/montimi i çdo materiali/pozicioni sipas projektit si dhe testimi i materialeve para lëshuarjes në punë. Sistemi i materialeve, pastrimi i punishtës nga mbeturinat gjatë dhe pas kryerjes së punimeve. Për të gjitha materialet dhe produktet ndërtimore që përdoren, paraprakisht të ofrohen certifikatat mbi kualitetin e tyre të cekura edhe në pozicion. Materialet dhe produktet ndërtimore siç janë dhënë në pozicion nuk duhet të ndryshohen apo zëvendësohen pa aprovim nga projektuesi.					
1 PUNËT NDËRTIMORE					
1.01 PUNËT PARAPREGADITORE					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSI A	SASIA	ÇMIMI / NJËSI	SHUMA
1.01.01	Rrethimi dhe sigurimi i punishtës me konstrukcion metalik dhe llamarinë të zinkuar me lartësi 2 m në tërë perimetrin e caktuar të vendpunishtës, respektivisht rbyllja e hyrje-daljeve në tunel, duke përfshirë edhe shenjëzimin informativ me tabelat informuese me dimensione 1.5x2 m të punuar nga profilet e hekurit dhe llamarina. Panelët për rbylljen e hyrje-daljeve duhet të kenë dyer të integruara për qasjen e automjeteve dhe personelit. Numri i hyrje-daljeve dy drejtimëshe: 6 Qerësia e hyrje-daljeve: 6-10 m	copë	6	500.00 €	3,000.00 €
1.01.02	Organizimi i punishtës dhe depove, furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriçimit të kantierit, vendosja e kontejnerit për zyren e menaxhimit të projektit dhe vendosja e VC kabinave për nevojat e punëtorëve.	copë	1	1,250.00 €	1,250.00 €
1.01.03	Mbntimi i strukturave/skeleve brenda tunelit dhe para hyrjeve në tunel duke përfshirë të gjitha masat masat mbrojtëse të nevojshme për qarkullimin e sigurtë të personelit dhe kalimtarëve pranë hyrje-daljeve në tunel.	copë	6	250.00 €	1,500.00 €
1.01.04	Pastrimi i tërësisë së tunelit dhe hyrje-daljeve pas përfundimit të punimeve nga të gjitha ndërtimet e përkohshme, rrethojat, mbeturinat inertë, anbalazhet dhe paketimet e materialeve,	copë	1	2,000.00 €	2,000.00 €
TOTAL POZICIONI				1.01	7,750.00 €
1.02 PUNËT E DEMONTIMIT DHE DEMOLIMIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSI A	SASIA	ÇMIMI / NJËSI	SHUMA
1.02.01	Demontimi i kanaleve të ventilimit të lokaleve afariste të cilat dalin ose kalojnë nëpër hapësirat e tunelit, mure apo plafon, duke përfshirë edhe njësitë e jashtme të këtyre pajisjeve si ventilatorët, motorët/kompressorët, shtëpizat/kornizat e ndryshme metalike brenda të cilave janë vendosur dhe të gjitha pjesët tjera që ndërlihen me funksionimin e tyre. Në çmim duhet të përfshihet transportimi dhe deponimi në deponë e përcaktuar nga organet komunale.	m ²	4,160	0.50 €	2,080.00 €
1.02.02	Demontimi i pajisjeve të klimatizimit të lokaleve afariste të cilat dalin ose kalojnë nëpër hapësirat e tunelit, mure apo plafon, duke përfshirë edhe njësitë e jashtme të këtyre pajisjeve si ventilatorët, motorët/kompressorët, shtëpizat/kornizat e ndryshme metalike brenda të cilave janë vendosur dhe të gjitha pjesët tjera që ndërlihen me funksionimin e tyre. Në çmim duhet të përfshihet transportimi dhe deponimi në deponë e përcaktuar nga organet komunale ose pronarët.	m ²	4,160	0.50 €	2,080.00 €

dieform

Address
Radovan Zogoviç Nr.97
Bllok C3 | HY A4
Prishtinë | Kosovë

E-mail:
info@dieform.space

1.02.03	Demontim i trupave ndriçuese dhe instalimeve elektrike të ndryshme të montuara në hapësirat e tunelit, mure apo plafon, duke përfshirë kabllimin me të gjitha pjesët përcjellëse deri në eliminimin e mbetjeve nga muret dhe plafoni. Në çmim duhet të përfshihet transportimi dhe deponimi në deponë e përcaktuar nga organet komunale.	m ²	4,160	0.25 €	1,040.00 €
1.02.04	Demontim i sistemit të vjetër të tubacioneve të hekurit për largimin e ujërave atmosferike me të gjitha pjesët përcjellëse pas identifikimit të bërë nga autoritetet përkatëse. Në çmim duhet të përfshihet transportimi dhe deponimi në deponë e përcaktuar nga organet komunale.	m ²	4,160	0.30 €	1,248.00 €
1.02.05	Demontim i rrjetave të sigurisë në hapjet e ventilimit në tavan/kulm 1. Rrjetë drejtëkëndëshe 2.4x6.4 m 2. Rrjetë drejtëkëndëshe 2.4x6.7 m 3. Rrjetë drejtëkëndëshe 2.4x4.7 m 4. Rrjetë rrethore Ø2.7 m Në çmim duhet të përfshihet transportimi dhe deponimi në deponë e përcaktuar nga organet komunale.	copë	4	650.00 €	2,600.00 €
1.02.06	Pastrim i të gjitha sipërfaqeve të brendshme të tunelit si muret, shtyllat, trarët dhe tavani me makineri me ujë me presion të lartë. Të gjitha sipërfaqet duhet të pastrohen deri në largimin e plotë papastërtisë, pluhurit dhe blazës. Si pas nevojës të aplikohet edhe pastrim manual me brusha metalike për largimin e materialeve të ngjitura dhe largimin e shtresave të dobëta të suvatimit.	m ²	9,636	0.35 €	3,372.60 €
TOTAL POZICIONI				1.02	12,420.60 €
1.03 PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSI A	SASI A	ÇM M / NJËSI	SHUMA
1.03.01	Furnizim me material dhe punim i tamponit nga zhavori me trashësi 20 cm me fraksion 0/31 për themelët pllakë të njeve të reja sanitare duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arritjen e kompaktësisë Ms=30 MPa	m ³	12.5	29.50 €	368.75 €
TOTAL POZICIONI				1.03	368.75 €

dieform

Address
Radovan Zogoviç Nr.97
Bllok C3 | HY A4
Prishtinë | Kosovë

E-mail:
info@dieform.space

1.04	PUNËT E BETONIT DHE ARMIMIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSI A	SASI A	ÇMIMI / NJËSI	SHUMA
1.04.01	Furnizimi me material, kallëpim dhe betonim i themel pllakave të nyjeve sanitare. Betonimi duhet të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji si Isomat Aquamat Admix në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos ndërsa sipërfaqja duhet të trajtohet me ferrobeton me ngjyrë hiri si Isomat EXTRA-TOP CR. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit. VËREJTJE: Para betonimit duhet të bëhet shtrirja e tubacioneve të kanalizimit sipas projektit të instalimeve hidrosanitare.	m ²	22.00	125.00 €	2,750.00 €
1.04.02	Furnizimi me material, kallëpim dhe betonim i pllakës së dyshemës tek moduli i bar kafesë. Betonimi duhet të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji si Isomat Aquamat Admix në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos ndërsa sipërfaqja duhet të trajtohet me ferrobeton me ngjyrë hiri si Isomat EXTRA-TOP CR. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit. VËREJTJE: Para betonimit duhet të bëhet shtrirja e tubacioneve të kanalizimit sipas projektit të instalimeve hidrosanitare.	m ²	34.50	125.00 €	4,312.50 €
1.04.03	Furnizimi me material, kallëpim dhe betonim i mureve për objektin e ri të nyjeve sanitare duke përfshirë nivelin e përdhësës dhe atikës. Betonimi duhet të bëhet me beton të markës c-25/30 me aditiv kristalor për arritjen e padepërtueshmërisë nga uji si Isomat Aquamat Admix në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ²	20.00	125.00 €	2,500.00 €
1.04.04	Furnizimi me material, kallëpim dhe betonim i pllakës nbi objektin e ri të nyjeve sanitare me trashësi 20 cm sipas projektit. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ²	7.50	125.00 €	937.50 €
1.04.05	Furnizimi me material, kallëpim dhe betonim i mureve të atikës nbi pllakën e objektit të ri të nyjeve sanitare. Muret duhet të jenë me trashësi 20 cm dhe lartësi 60 cm. Betonimi të bëhet me beton të markës c-25/30. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse, distancuesit dhe kallëpet e nevojshme e nevojshme për realizimin e pozicionit.	m ²	3.80	125.00 €	475.00 €
1.04.06	Shqyrtim i gjendjes ekzistuese të konstruksionit të pllakës për rrjedhjet eventuale të ujërave atmosferik, furnizim me material dhe injektim i masës hidroizoluese për nbylljen e vrimave në konstruksion. Pas shqyrtimit të pllakës të hartohet raporti për gjendjen e saj dhe të kërkohet aprovim nga investitori/nbyllësi për intervenimet e mëtejme. Për këtë qëllim mund të përdoret masa hidroizoluese dykomponentëshe nga poliuretani si ISOMAT FLEX PU-2K ose prodhim tjetër i ngjashëm	m ²	4,160	1.30 €	5,408.00 €
1.04.07	Armaturë Ø 8 mm	kg	1,305.64	1.00 €	1,305.64 €
1.04.08	Armaturë Ø 10 mm	kg	1,003.90	1.00 €	1,003.90 €
1.04.09	Armaturë Ø 12 mm	kg	210.50	1.00 €	210.50 €
TOTAL POZICIONI				1.04	18,903.04 €

dieform

Address
Radovan Zogoviç Nr.97
Bllok C3 | HY A4
Prishtinë | Kosovë

E-mail:
info@dieform.space

1.05 PUNËT E MURATI M T DHE I ZOLI M T					
POS	PËRSHKRI M I PUNËVE	NJËSI A	SASI A	ÇM M / NJËSI	TOTAL
1.05.01	Furnizim me material dhe muratim i mureve të jashtme/perimetrike dhe i atyre të brendshme ndarëse me trashësi të ndryshme me blloqe porozbetoni me përbërje minerale joorganike. Blloqet e tilla të porozbetonit si ato nga prodhuesi Silcapor duhet të muratohen/ngjiten me ngjitës adekuat të përfituar me përzierjen me ujë si pas specifikimeve të prodhuesit. Si përfaqet horizontale dhe vertikale të lyhen me shtresën e ngjitësit të parapërgaditur me anë të mjeteve/lopatave të posaçme për shtrirjen e njëtrajtshme të ngjitësit. Prerja e blloqeve të bëhet me sharrë elektrike të posaçme ose me sharrë dore duke përdorur mjete e nevojshme për prerje të drejtë. Gatë muratimit duhet të respektohen udhëzimet teknike të prodhuesit si muratim i rendit të parë duke e nivelizuar me shtresë llaçi të çimentos me trashësi 2-3 cm ku çdo i treti rend duhet të fiksohet me lidhëse elastike të zinkuara për shtyllat e betonit. Në mes të mureve dhe shtyllave duhet të lihet fuga me gjerësi 1 cm ndërsa në mes të murit dhe trarëve ose pllakës meskatëshe duhet të lihet fuga me gjerësi 2 cm Të gjitha fugat duhet të mbushen me shkumë montuese poliuretani për të mundësuar dilatatimn e elementeve konstruktive. Peshë Vëllimore (γ) = 400-700 kg/m ³ Koeficienti i përshueshmërisë së avullit μ = 0.00 W/mK	m ³	1.50	105.00 €	157.50 €
a.	Muratim i mureve perimetrike me trashësi 25 cm me blloqe porozbetoni të tipit Silcapor 60x25x25 cm (LxHxB)	m ³	1.50	105.00 €	157.50 €
a.	Muratim i mureve perimetrike me trashësi 12 cm me blloqe porozbetoni të tipit Silcapor 60x25x12 cm (LxHxB)	m ³	14.00	100.00 €	1,400.00 €
1.05.02	Furnizim me material dhe punim i shtresës termizoluese në fugën e dilatatimit të nyjet e reja sanitare përgjatë pjesëve ku takohet me konstruksionin ekzistues në mure dhe atikë. Për këtë duhet të përdoret XPS t=12 cm ndërsa në pjesën e atikës XPS t=5 cm	m ²	66.00	14.00 €	924.00 €
1.05.03	Furnizim me material dhe punim i kapakut dilatues nga lllamrina e galvanizuar për vijën kontaktuese horizontale mes traut ekzistues dhe pllakës së re dhe për dilatatimn vertikal mes nyjes sanitare dhe murit ekzistues.	m	10.00	13.50 €	135.00 €
TOTAL POZICI QINI				1.05	2,616.50 €
1.06 PUNËT E SUVATI M T					
POS	PËRSHKRI M I PUNËVE	NJËSI A	SASI A	ÇM M / NJËSI	SHUMA
1.06.01	Furnizim me material dhe suvatim i tërësishtëm i mureve në të gjitha këthinat e brendshme të nyjeve të reja sanitare. Suvatim duhet të bëhet me material/llaç të parapërzier si RÖFIX 510 (gëlqere+çiment+agregat) ose me material të ngjashëm me trashësi 15 mm Në çmim të përfshihet trajtim paraprak i bazës me llaç sprucues RÖFIX 670 ose material të ngjashëm listellat metalike për caktimn e trashësisë së llaçit, këndoret metalike, listellat dilatuese (anputzlesite) nga plastika me rrjetë armim dhe shirit vetngjitës për dyer dhe dritare dhe mbrojtja e të gjitha pozicioneve të zdrukhtarisë me folie të PVC-së si dhe rrjeta e PVC-së me fije qelqi për përforcimn e llaçit në çdo pjesë ku kalohet nga një material në tjetrin si blloqe-beton.	m ²	240.00	7.30 €	1,752.00 €
1.06.02	Furnizim me material dhe suvatim i anës së brendshme të atikës së terasës së hapur, kulmit të rrafshhtë dhe kulmit të ashensorit me llaç të parapërzier si RÖFIX 510 (gëlqere+çiment+agregat) ose me material të ngjashëm adekuat për aplikim në eksterier. Suvatim të bëhet i rrafshhtë dhe i lëmuar në mënyrën më të mirë të mundshme me një shtresë me trashësi deri në 20 mm e cila do të shërbejë si bazament për aplikimn e masave hidroizoluese.	m ²	12.00	17.00 €	204.00 €
TOTAL POZICI QINI				1.06	1,956.00 €

dieform

Address
Radovan Zogoviç Nr.97
Bllok C3 | HY A4
Prishtinë | Kosovë

E-mail:
info@dieform.space

1.07 PUNËT E NGJYROSJES					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSI A	SASI A	ÇMIMI / NJËSI	SHUMA
1.07.01	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve, shtyllave dhe plafoneve me dy shtresa ngjyrë për mbrojtjen e betonit si TAKRIL Classic nga prodhuesi JUB ndërsa për mbrojtjen e dyerve metalike në brendësi të tunelit të përdoret ngjyrë adekuate e yndyrshme - 2 shtresa me nuancë të njëjtë si muret RAL 9023. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me lyster bazë/primer për eksterier si JUKOLprimer të tretur në ujë në raport 1:1 për reduktimin e shkallës së apsorbitimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjitjes, etj. Ngjyra Takril Classic duhet të aplikohet në dy deri tri shtresa, 6 deri 12 orë pas aplikimit të bazës/primerit. Përberja kimike: lidhës akrilik, mbushës alumsilikati dhe sulfati, dendësues celuloze, pigmente dhe ujë.	m ²	9,636.00	5.10 €	49,143.60 €
1.07.02	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve të brendshme të njeve të reja sanitare me dy shtresa ngjyrë me bazë poliuretani rezistente ndaj lagështisë. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me bazë/primer adekuat për eksterier për reduktimin e shkallës së apsorbitimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjitjes, etj. Ngjyra RAL 3013	m ²	220.00	7.00 €	1,540.00 €
1.07.02	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve të brendshme të njeve të reja sanitare me dy shtresa ngjyrë me bazë poliuretani rezistente ndaj lagështisë. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me bazë/primer adekuat për eksterier për reduktimin e shkallës së apsorbitimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjitjes, etj. Ngjyra RAL 9010	m ²	21.00	12.50 €	262.50 €
1.07.03	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve të tunelit të dedikuara për vizatim me ngjyrë e cila mundëson vizatimin dhe shlyerjen e tyre si DECOR Blackboard paint. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me bazë/primer adekuat për eksterier për reduktimin e shkallës së apsorbitimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjitjes, etj.	m ²	59.00	12.50 €	737.50 €
TOTAL POZICIONI				1.07	51,683.60 €

diefORM

Address
Radovan Zogoviç Nr.97
Bllok C3 | HY A4
Prishtinë | Kosovë

E-mail:
info@diefORM.space

1.08 PUNËT E QERAM KËS						
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSI A	SASI A	ÇMIMI / NJËSI	SHUMA	
1.08.01	Furnizim me material dhe mveshja e mureve modulit të Bar Kafesë dhe sipërfaqet tjera të përcaktuara në projekt me pllaka të glazuara qeramike me dimensione, ngjyrë të bardhë dhe dimension 15x15 cm Pllakat për mure duhet të jenë rezistente ndaj ndryshimeve të temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë të vogël të thithjes së lagështisë, rezistente ndaj abrazionit, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit të njollave. Ngjitja e pllakave të bëhet me ngjites kualitativ fleksibil dhe hidroizolues si Ceresit CM1 Plus me fuga të gjera 3 mm Masa për mbushjen e fugave duhet të jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit si Ceresit CE40.	m ²	157.00	29.00 €	4,553.00 €	
TOTAL POZICIONI				1.08	4,553.00 €	
1.09 PUNËT E MOBILJEVE URBANE DYERVE, DRI TAREVE DHE ELEMENTET TJERA NGA METALI						
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSI A	SASI A	ÇMIMI / NJËSI	SHUMA	
1.09.01	Furnizim dhe montim i mobiljeve urbane të punuara nga profilet dhe llamarinat e metalit të galvanizuar sipas skemave dhe specifikimeve në projekt duke përfshirë edhe montimin me të gjitha mjetet e nevojshme për lidhje dhe fiksime Mobiljet urbane janë të tipeve të ndryshme për funksione të caktuara, të vendosura në pozita të përhershme ose mund të jenë lëvizëse për zhvendosje/ngritje në shtëpizën ku qëndrojnë deri në kohën e shfrytëzimit. Mobiljet urbane janë të projektuara për qëndrueshmëri dhe rezistencë ndaj vandalizimit dhe të mbrojtura nga korozioni me anë të galvanizimit (të zinkuara). Të gjitha saldimet e elementeve duhet të jenë të plota, me trashësi min.4 mm ndërsa skajet e lira të shufrave të rrjetave duhet të saldohen në kornizat e tyre nga ana e brendshme. Elementet nuk guxojnë të kenë skaje ose pjesë të mprehta që mund të shkaktojnë lëndime dhe prerje. Saldimi duhet të bëhet nga punëtorë të certifikuar. Në çmim duhet të përfshihet përdorimi i të gjitha mjeteve tjera përcjellëse të nevojshme për realizimin e pozicioneve në vazhdim si shkallë, skelë fikse ose të lëvizshme, vinça, etj. Në pjesët e betonit duhet të përdoren anker bulona adekuat me diametër min.12 mm dhe gjatësi 8-10 cm ndërsa për pjesët e mureve nga blloqet e argjilës ose materialët tjera të përdoren tiplla ankerimi me koka plastike adekuate për materialët ku aplikohen.					
a.	DET 01 Mbuli i Homazheve Korniza modulare me rrjeta metalike dhe pllaka metalike për dedikime/homazhe. Dimensionet: 215x494 cm Dukja si në skemën në A.02.01 - A.02.02	copë	12	500.00 €	6,000.00 €	
b.	DET 02 Mbuli i Pasqyrave Korniza metalike fikse me pasqyra rrotulluese inoksi rreth aksit vertikal. Dimensionet totale: 16.78x4.92 m Komponentat: Kornizat fikse 20x450 cm Pasqyrat 14x437 cm Dukja si në skemën në A.02.03 - A.02.04	copë	66	195.00 €	12,870.00 €	
c.	DET 03 Mbuli i Bar Kafesë Banaku nga tubat e galvanizuar metalik dhe pult nga mediapani i veshur me llamarinë me trashësi 2 mm Konstrukcioni bartës të punohet nga profilet 50x50x2.5 mm Dimensionet: 900x230 cm Dukja si në skemën në A.02.05 - A.02.07	copë	1	2,500.00 €	2,500.00 €	
d.	DET 06 Mbuli i Projektorëve/Monitorëve Mbuli përbërë nga shumë monitorë Dimensionet e monitorëve: 60x34 cm Dimensionet totale: 600x400 cm Në çmim të përfshihet edhe konstrukcioni mbajtës për fiksime në mur. Dukja si në skemën në A.02.13	copë	13	16,780.00 €	218,140.00 €	

dief orm

Address
Radovan Zogoviç Nr.97
Bllok C3 | HY A4
Prishtinë | Kosovë

E-mail:
info@dief orm.space

e.	<p>DET 07 Mbduli i tregjeve Konstruksione metalike me rrjeta metalike dhe elemente që transformohen në forma të ndryshme në varësi nga funksioni i momentit. Dimensionet: 576x390x33 cm Dukja si në skemën në A.02.14 - A.02.15</p>	copë	5	12,480.00 €	62,400.00 €
f.	<p>DET 08 Mbduli i karrikave Konstruksione metalike me rrjeta metalike dhe pjesë lëvizëse që transformohen në ulëse. Dimensionet: 190x400 cm Dukja si në skemën në A.02.16 - A.02.17</p>	copë	4	400.00 €	1,600.00 €
g.	<p>DET 10 Mbduli i panaireve Konstruksione metalike lëvizëse me rrjeta metalike dhe elemente që transformohen në forma të ndryshme në varësi nga funksioni i momentit. Dimensionet: 270x300x30 cm Dukja si në skemën në A.02.19 - A.02.20</p>	copë	20	380.00 €	7,600.00 €
h.	<p>DET 12 Mbduli i Orës Digjitale i përbërë nga 4 njësi monitorësh për tregimin e kohës. Dimensionet e monitorëve: 60x400 cm Dimensionet totale: 995x400 cm Në çmim duhet të përfshihet edhe konstruksioni metalik me profile 40x40x2.5, pllaka të perforuara metalike me prerje laserike t=5mm dhe plexi glass 3mm Dukja si në skemën në A.02.22 - A.02.23</p>	copë	1	26,000.00 €	26,000.00 €
i.	<p>DET 13 Platforma metalike për skenë performuese me mekanizëm për ngritje në tavan. Konstruksione nga profilet metalike, pllaka metalike 2 mm Të gjitha elementet duhet të jenë të galvanizuara. Platforma duhet të ketë rrota në çdo nyje sipas projektit dhe mekanizëm ngritës të zingjir për ngritje manuale në nivelin e tavanit. Dimensionet: 5.0x6.0 m Lartësia 35cm Dukja si në skemën në A.02.24 - A.02.26</p>	copë	2.0	850.00 €	1,700.00 €
j.	<p>DET 14 Rrjeta sigurie për hapjet e ventilimit në tavan Konstruksione nga profilet metalike dhe rrjetat metalike të galvanizuara. Dimensionet: 1. Rrjetë drejtëkëndëshe 2.4x6.4 m 2. Rrjetë drejtëkëndëshe 2.4x6.7 m 3. Rrjetë drejtëkëndëshe 2.4x4.7 m 4. Rrjetë rrethore Ø2.7 m Dukja si në skemën në A.02.27</p>	m ²	48.5	55.00 €	2,667.50 €
k.	<p>DET 15 Rrjeta për plafonin e lëshuar në modulën e bar kafesë. Konstruksione nga profilet metalike dhe rrjetat metalike të galvanizuara. Konstruksioni bartës realizohet nga "L" profilet e fiksuara në perimetër, "T" profilet në fushat e mesme të varura me grepa të ankeruar në plafon, ndërsa mbushja realizohet me elemente katrore të punuara nga korniza me "L" profile dhe rrjeta nga teli i çelikut Ø4 mm Sistemi realizohet ngjashëm me plafonin e lëshuar modular të tipit "Armstrong" me 3x6 fusha. Dimensionet: 1. Rrjetë drejtëkëndëshe 3.2x6.4 m 3 copë</p>	m ²	60	25.00 €	1,500.00 €

dieform

Address
Radovan Zogoviç Nr.97
Bllok C3 | HY A4
Prishtinë | Kosovë

E-mail:
info@dieform.space

l.	<p>POS D01 Dyer njëkrahëshe metalike Pllaka e profiluar "U" me trashësi 4 mm Krahu i derës I djathtë a. Korniza 40x40x3 mm b. Veshja Llanarinë 2 mm Mënteshat Cilindrike dy pjesëshe të salduara Dorezat Çelik Dorezë vertikale fikse Brava Euro cilindër mesingu me çelës. Tipi me 6 gjilpëra Ngjyra RAL 3013 Mbrojtja nga korozi oni Galvani zi m dhe plastifikim Dimensionet: 100x240 cm Dukja si në skenën në A.03.04</p>	copë	4	575.00 €	2,300.00 €
m	<p>POS D02 Dyer njëkrahëshe metalike Pllaka e profiluar "U" me trashësi 4 mm Krahu i derës I majtë a. Korniza 40x40x3 mm b. Veshja Llanarinë 2 mm Mënteshat Cilindrike dy pjesëshe të salduara Dorezat Çelik Dorezë vertikale fikse Brava Euro cilindër mesingu me çelës. Tipi me 6 gjilpëra Ngjyra RAL 7016 Mbrojtja nga korozi oni Galvani zi m dhe plastifikim Dimensionet: 100x240 cm Dukja si në skenën në A.03.04</p>	copë	3	575.00 €	1,725.00 €
n.	<p>POS D02 Derë njëkrahëshe metalike me hapje rreth aksit qendror vertikal (PIVOT) Krahu e derës Profile 60x40x3 mm Mbushja polikarbonat 16 mm Korniza e mbushjes me bulona në çdo 160 mm Mënteshat Aksial e-Pivot me kushi net a Ngjyra RAL 3013 Mbrojtja nga korozi oni Galvani zi m dhe plastifikim Dimensionet: 172x332 cm Dukja si në skenën në A.02.08</p>	copë	1	1,100.00 €	1,100.00 €
o.	<p>POS K1 Korniza fikse metali për muret nga prizmat e xhamit Kornizat punohen nga profilet metalike 80x40x3 mm Dimensionet: a. 210x365 cm b. 250x415 cm Ngjyra RAL 3013 Mbrojtja nga korozi oni Galvani zi m dhe plastifikim</p>	m	25	20.00 €	500.00 €
p.	<p>POS V1 Veshja e vertikaleve të ventilimit Tipi 1 Struktura bartëse nga profilet vertikale 40x40x2 mm në 4 këndet me profile horizontale në çdo 1 m Ankerimi në mur me 2 anker bulona në çdo 1 m Mbrojtja nga korozi oni Primer dhe 2 shtresa ngjyrë Veshja e jashtme HPL panele 6 mm ngjyra e ngjashme me fasadën ku montohet. Dimensionet e prerjes tërthore 60x60 cm Lartësia e veshjeve 30 m Numri i vertikaleve 3 copë Dukja si në skenën në A.02.28</p>	m	90	132.00 €	11,880.00 €

dieform

Address
Radovan Zogoviç Nr.97
Bllok C3 | HY A4
Prishtinë | Kosovë

E-mail:
info@dieform.space

q.	<p>POS V2 Veshja e vertikaleve të ventilimit Tipi 2 Struktura bartëse nga profilet vertikale 40x40x2 mm në 4 këndet me profile horizontale në çdo 1 m Ankerimi në mur me 2 anker bulona në çdo 1 m Mbrotjtja nga korozioni Primer dhe 2 shtresa ngjyrë</p> <p>Veshja e jashtme HPL panele 6 mm ngjyra e ngjashme me fasadën ku montohet. Dimensionet e prerjes tërthore 80x60 cm Lartësia e veshjeve 30 m Numri i vertikaleve 5 copë Dukja si në skemën në A.02.28</p>	m	150	148.00 €	22,200.00 €
r.	<p>POS V3 Veshja e rekueratorëve Struktura bartëse në formë kutie nga profilet vertikale 20x20x2 mm në 4 këndet së paku me një ndarje në mes. Ankerimi në mur me 8 anker bulona dhe 2 litra diagonal për pjesën e konzolës. Mbrotjtja nga korozioni Primer dhe 2 shtresa ngjyrë</p> <p>Veshja e jashtme nga anash dhe poshtë HPL panele 6 mm ngjyra e ngjashme me fasadën ku montohet. Ana e epërme Kapak nga lllamari na e plastifikuar me 2 ramje për largimin e ujërave atmosferik ngjyra e ngjashme me fasadën ku montohet. Dimensionet e veshjes 130x140x95 cm Dukja si në skemën në A.02.28</p>	copë	7	450.00 €	3,150.00 €
s.	<p>MURE NGA BILLOQET E QELQIT Furnizimi me material dhe punimi i mureve ndarëse nga bloqet e qelqit para hyrjeve të njeve sanitare. Bloqet e qelqit duhet të punohen sipas rregullave me elementet e posaçme për fugat dhe armim sipas udhëzimeve të prodhuesit. Bloqet e qelqit tipi Quadra GRID Dimensionet 19x19x8 cm Fugat 1 cm</p>	m ²	17	58.00 €	986.00 €
TOTAL POZICIONI				1.09	386,818.50 €

dieform

Address
Radovan Zogoviç Nr.97
Bllok C3 | HY A4
Prishtinë | Kosovë

E-mail:
info@dieform.space

1.11 PUNËT E INVENTARIT TË TUALETEVE					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSI A	SASI A	ÇMIMI / NJËSI	SHUMA
1.10.01	Furnizim dhe montim i njësive shumëpjesëshe me dyer dhe panele ndarëse për kabina të WC-ve dhe pisoarë, të punuara nga panelët HPL dhe këmbët me lartësi të ndryshueshme. Materiali: Lam nex - Austria ose prodhues i cilësisë së njëjtë. Paneli: Lam nex Multipurpose Compact - 13 mm HPL (High Pressure Laminate) rezistent ndaj gërvishjeve, ngjyrës, goditjeve, thyrjeve dhe lagështisë. Fiksimi me profile alumini në mure dhe shtangim gjatësor me profile alumini në anën e epërme të paneleve Ngjyra: E hirtë RAL 3013				
a.	POS T01 Kabina për 6 WC të përbëra nga: • 2 panele ndarës 110x220 cm rbi këmbëza • 1 ballore me 3 dyer gjerësia 620x220 cm • 1 ballore me 3 dyer gjerësia 325x220 cm (dyert - 60 cm hapja jashtë) Të gjitha pjesët të llogariten si një tërësi / copë Dukja si në skemën në A.03.02	copë	1	2,750.00 €	2,750.00 €
b.	POS T02 Kabina për 1 WC të përbëra nga: • 1 panele ndarës 215x220 cm rbi këmbëza • 1 ballore me 3 dyer gjerësia 300x220 cm (dyert - 60 cm hapja jashtë) Të gjitha pjesët të llogariten si një tërësi / copë Dukja si në skemën në A.03.03	copë	1	360.00 €	360.00 €
1.10.02	POS M-01 Furnizim dhe montim i lavamanave për 4 persona dhe dollap me shportë të integruar për mbeturina Nënkonstruksioni metalik Panele MDF me veshje Inoksi Lavamani duhet të jetë i kompletuar me bateri uji nga inoksi dhe sifona individual për secilin njësi. Ujëmbledhësit duhet të jenë të mbuluar me kapak dekorativ që hiqen lehtë për pastrim Dimensionet 302x55x90 cm Dukja si në skemën në A.03.01	copë	3	2,500.00 €	7,500.00 €
1.10.03	POS M-04, 05 Furnizim dhe montim i WC guaskave të qeramiks Tipi i montuar në dysheme Kazan uji i integruar WC guaska duhet të jetë e kompletuar me të gjithë ventilat dhe tubat e nevojshme për furnizim dhe pastrim dhe kapak me rbyllje të ngadalte Dukja si në skemën në A.02.11	copë	7	155.00 €	1,085.00 €
1.10.04	POS M-04, 05 Furnizim dhe montim i WC guaskave të qeramiks me të gjitha elementet përcjellëse për persona me aftësi të kufizuara (mbajtësit në tokë dhe mure) Tipi i montuar në dysheme Kazan uji i integruar WC guaska duhet të jetë e kompletuar me të gjithë ventilat dhe tubat e nevojshme për furnizim dhe pastrim dhe kapak me rbyllje të ngadalte Dukja si në skemën në A.02.12	copë	3	325.00 €	975.00 €
1.10.05	POS M-01 Furnizim dhe montim i dollapave me pasqyra dhe aksesori të integruar për sapun të lëngët dhe letra higjienike Dollapi duhet të jetë nga inoxi pa shkëlqim ndërsa pasqyra nga inoksi me finish pasqyre. Dollapi punohet me 4 njësi të bashkuara në një. Dimensionet: 300x100x22 cm Dukja si në skemën në A.03.01	copë	3	980.00 €	2,940.00 €
TOTAL POZICIONI				1.11	15,610.00 €

dieform

Address
Radovan Zogoviç Nr.97
Bllok C3 | HY A4
Prishtinë | Kosovë

E-mail:
info@dieform.space

1.11	PUNËT E KULMIT TË RRAFSHËT DHE PUNËT E LLAMARINËS				
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSI A	SASIA	ÇMIMI / NJËSI	SHUMA
1.11.01	<p>Furnizim me material, përpunim i materialeve dhe punim i kulmit të rrafshët të pashfrytëzueshëm me pjerrësi 2% mbi objektin e ri të nyjeve sanitare. Kulmi realizohet me të gjitha shtresat e nevojshme si pendën e avullit, termozolimn me shtresa plotësuese pllakash për krijimin e kaskadave siç është specifikuar në projekt, shtresën ndarëse, shtresën për ramje, shtresën hidroizoluese nga PVC membranë dhe zhavorin e lumit si shtresë mbrojtëse. Vazhdimet e folieve të bëhen me mbikalim për së paku 10 cm ose sipas udhëzimeve të prodhuesit dhe të ngjiten me shiritë adekuat vetngjithës. Të gjitha punët rreth kulmit të rrafshët duhet të realizohen nga punëtorët e specializuar e në veçanti ngjitja e PVC membranës duhet të realizohet nga punëtorë e certifikuar për këtë fushë.</p> <p>Vërejtje: Si përfaqet e folieve dhe PVC membranës janë dhënë si sipërfaqe NETO pa përfshirë pjesën e nevojshme për ngjitje mbi njëra tjetrën.</p> <p>Në çmim përfshihet realizimi i të gjitha shtresave të paraqitura në vijim si totale të përgjithshme për këto pjesë:</p>				
a.	SI KA TL- Sarnavap 500 E ose material i ngjajshëm Pendë avulli me bazë polietileni e vendosur lirisht mbi bazamentin e betonit. Vazhdimet të bëhen me mbikalim prej 10 cm dhe të izolohen me shiritë ngjithës adekuat. Trashësia: 0.15 mm Pesha: 145 gr/m ²	m ²	24.00	2.75 €	66.00 €
b.	POFIX - P06 ose material i ngjajshëm Termozolim EPS-25 kg/m ³ me trashësi 10 cm	m ²	24.00	9.50 €	228.00 €
c.	Folie e PE-së t= 0.15mm si shtresë ndarëse mbi termozolim Vazhdimet të bëhen me mbikalim prej 10 cm dhe të izolohen me shiritë ngjithës adekuat.	m ²	24.00	1.00 €	24.00 €
d.	Beton për ramje Trashësia min.5 cm me kaskada sipas projektit, i armuar me rrjetë Q 069 - 4.2x4.2 mm me fusha	m ²	24.00	6.40 €	153.60 €
e.	Si kaRoof® Felt A-300 F ose material i ngjajshëm Geotekstil 300 gr/m ² - shtresa e parë mbi betonin për ramje dhe veshja e pjesëve vertikale si shtresë ndarëse dhe bazë për PVC membranën. Vazhdimet të bëhen me mbikalim prej 10 cm dhe të ngjiten me aplikimin e nxehtësisë.	m ²	36.00	2.15 €	77.40 €
f.	Si kaplan SGA-18 ose membranë tjetër e ngjashme. PVC membranë sintetike shumë shtresore e përforcuar me fije të qelqi e vendosur lirisht mbi shtresën e betonit/bazës si Trashësia 1.8 mm Vazhdimi i membranave me ngjitje me saldim sipas udhëzimeve të prodhuesit. Në çmim të përfshihen elementet fazonike për depërtimet e ndryshme mbi kulmin e rrafshët, këndet e ndryshme, dhe profilet e nevojshme nga llamari i plastifikuar për ngjitjen e membranës në kënde ose pjesë vertikale si dhe fiksimit shtesë mekanik mbi bazën e betonit. Të gjitha elementet e përdorura për realizimin e kullit të jenë kompatible dhe nga i njëjti prodhues.	m ²	36.00	18.50 €	666.00 €
g.	Si kaRoof® Felt A-300 F ose material i ngjajshëm Geotekstil 300 gr/m ² - shtresa e dytë mbi PVC membranën si shtresë ndarëse dhe bazë për zhavorin ose mbajtësit/distancerat e pllakave. Vazhdimet të bëhen me mbikalim prej 10 cm dhe të ngjiten me aplikimin e nxehtësisë.	m ²	24.00	2.50 €	60.00 €
h.	Zhavori i lëmuar lum me trashësi 5 cm me granulacion të mesëm për mbrojtjen e PVC membranës. Pesha: 3.50 kg/m ²	m ²	24.00	3.50 €	84.00 €

dieform

Address
Radovan Zogoviç Nr.97
